



**RAPORT I VLERËSIMIT TË STAFIT AKADEMIK NGA
STUDENTËT**

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

Zyra për Sigurimin e Cilësisë

Semestri Dimëror 2023/2024

Shkurt, 2024

HJRJE

Hartimi i raportit të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë për vlerësimet e stafit akademik nga studentët, përmes pyetësorëve, ka si qëllim kryesor të mbledhë të dhëna të besueshme dhe të drejtpërdrejta nga studentët për të vlerësuar performancën e stafit akademik, të identifikojë fushat që kërkojnë përmirësim, të nxisë transparencën dhe përgjegjshmërinë, të ndërtojë plane veprimi për adresimin e çështjeve të ngritura, të rrisë përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse, dhe të monitorojë progresin e zbatimit të rekomandimeve.

Administrimi i pyetësorëve, analiza e të dhënave dhe hartimi i raportit nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë realizohen në përputhje të plotë me udhëzuesin për sigurim të cilësisë dhe kryhen dy herë gjatë vitit akademik. Ky proces përfshin mbledhjen sistematike të vlerësimeve të stafit akademik nga studentët përmes pyetësorëve të strukturuar, të cilët administrohen në përfundim të çdo semestri. Pas mbledhjes së të dhënave, bëhet një analizë e thellë e cila ndikon në përmirësimin e mësimdhënies dhe të përvojës së të mësuarit. Hartimi i raportit pasqyron rezultatet e kësaj analize të përbëra nga:

- Kompetencat e mësimdhënësit për lëndën
- Zbatimi i përmbajtjes së syllabusit
- Metodologjia e mësimdhënies
- Metodatat e vlerësimit
- Përgjegjësit etike dhe profesionale

Pyetëtori për vlerësimin e stafit akademik përbëhet nga 6 pyetje dhe studentët janë përgjigjur sipas shkallës së Likërit në 5 nivele të ndryshme të pajtueshmërisë nga “nuk pajtohem aspak” deri në “pajtohem plotësisht”. Në vazhdim, për çdo pyetje të pyetëtorit janë paraqitur në formë grafike vlerësimet e përgjithshme të studentëve, ndërsa, në fund të raportit janë dhënë rekomandime të përgjithshme për përmirësim.

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I STAFIT AKADEMIK NGA STUDENTËT NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE

Figura 1. Vlerësimi i përgjithshëm i stafit akademik nga studentët në Fakultetin e Shkencave Mjekësore






Figura më lartë tregon se shumica e studentëve në Fakultetin e Shkencave Mjekësore vlerësojnë pozitivisht punën e stafit akademik. Me 45% të tyre që pajtohen plotësisht dhe 35% që pajtohen, kjo përfaqëson një mbështetje të fuqishme për stafin. Në anën tjetër, një pjesë e konsiderueshme e studentëve, rreth 15%, janë neutralë, ndërsa një përqindje më e vogël, 5%, kanë dyshime ose mosmarrëveshje me performancën e stafit.

Figura 2. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për përgatitjen dhe kompetencat e stafit akademik




Grafikoni paraqet një vlerësim shumë të favorshëm të stafit akademik nga studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Në total, 49% e studentëve pajtohen plotësisht me përgatitjen dhe kompetencat e tyre, ndërsa një përqindje e rëndësishme, 32%, pajtohen. Në të njëjtën kohë, 14% janë neutralë në vlerësimin e tyre, ndërsa vetëm 3% nuk pajtohen dhe 2% nuk pajtohen aspak. Këto shifra dëshmojnë për një nivel të lartë besimi dhe respekti ndaj punës së stafit akademik në fushën e shkencave mjekësore.

Figura 3. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për respektimin dhe përmbajtjen e syllabusit nga ana e stafit akademik




Përqindjet e dhëna në grafik tregojnë një perceptim pozitiv të studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për respektimin dhe përmbajtjen e syllabusit nga stafi akademik. Me 48% të studentëve që pajtohen plotësisht dhe 37% që pajtohen, duket se shumica e tyre kanë një kuptim të mirë të strukturës dhe përmbajtjes së programit akademik. Në anën tjetër, 12% janë neutralë, ndërsa vetëm një përqindje e vogël, 2% nuk pajtohen dhe 1% nuk pajtohen aspak.

Figura 4. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për format e mësimdhënies dhe angazhimin e tyre në klasë nga stafi akademik




Në figuren e dhënë, Studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore shprehin një vlerësim të mirë për format e mësimdhënies dhe angazhimin e stafit akademik në klasë. Shumica, 43%, pajtohen plotësisht, ndërsa 33% pajtohen. Megjithatë, 18% janë neutralë në vlerësimin e tyre. Në anën tjetër, 4% nuk pajtohen dhe 2% nuk pajtohen aspak. Këto shifra tregojnë për një spektër të ndryshëm të perceptimeve, por në përgjithësi ka një nivel të lartë pajtimi me mësimdhënien dhe angazhimin e stafit akademik.

Figura 5. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për inkurajimin, pjesëmarrjen aktive, të menduarit kritik dhe të pavarur nga stafi akademik




Në grafikun e paraqitur, studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore shprehin një vlerësim për inkurajimin, pjesëmarrjen aktive, të menduarit kritik dhe të pavarur nga stafi akademik. Me 45% të tyre që pajtohen plotësisht dhe 35% që pajtohen, kjo tregon një mbështetje të ndjeshme për praktikatat e inkurajimit. Megjithatë, 16% janë neutralë, ndërsa 4% nuk pajtohen dhe nuk pajtohen aspak. Kjo tregon për një përputhje të gjerë me praktikatat inkurajuese, pjesëmarrjen aktive dhe të menduarit kritik, por gjithashtu dëshmon për disa hapësira për përmirësim për të përshtatur më mirë për nevojat e të gjithë studentëve.

Figura 6. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për gatishmërinë e stafit akademik në përgjigjen ndaj kërkesave të tyre



Në figurën e dhënë është paraqitur vlerësimi i studentëve për gatishmërinë e stafit akademik në përgjigjen ndaj kërkesave të tyre tregon një përputhje të ndjeshme. Shumica, ose 77% e studentëve, pajtohen në ndonjë mënyrë me reagimin e stafit akademik ndaj tyre. Në detaje, 40% pajtohen plotësisht, ndërsa 37% pajtohen. Megjithatë, një përqindje prej 17% janë neutralë në këtë vlerësim, duke treguar për një nivel të caktuar mosbesimi ose moskuptimi. Në anën tjetër, 6% nuk pajtohen, ndërsa 3% nuk pajtohen aspak, një shifër relativisht e vogël, por ende e rëndësishme.

Figura 7. Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për gatishmërinë e stafit akademik ndaj kërkesave të tyre



Bazuar në të dhënat e figures, vlerësimi i studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për gatishmërinë e stafit akademik ndaj kërkesave të tyre është në përgjithësi pozitiv. Shumica, ose 80%, pajtohen në ndonjë mënyrë me reagimin e stafit. Në detaje, 43% pajtohen plotësisht, 37% pajtohen, dhe 16% janë neutralë. Megjithatë, një përqindje më e vogël, 4% nuk pajtohen ose nuk pajtohen fare. Këto shifra tregojnë për një gamë të ndryshme reagimesh, por gjithashtu tregojnë për një nivel të përputhjes së gjerë me kërkesat e studentëve nga stafi akademik.


ANALIZA E VLERËSIMEVE NGA ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Zyra për Sigurimin e Cilësisë ka analizuar vlerësimet e stafit akademik nga studentët në vlerësime pozitive (pajtohem dhe pajtohem plotësisht) dhe vlerësime negative (nuk pajtohem dhe nuk pajtohem aspak) të cilat janë të paraqitura në aneks të këtij dokumenti, përkatësisht tabela A1 dhe A2.

Kriteret për vlerësime pozitive janë: vlerësim maksimal, vlerësim mesatar, vlerësim i ulët dhe vërtetje.


Kriteret për vlerësime negative janë: Në rregull (nuk ka vlerësim negativë), vlerësim negativë dhe vërejtje.

Figura 8. Analiza e vlerësimeve pozitive sipas kriterëve nga ZC për stafin akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore




Nga të dhënat e analizës së vlerësimeve pozitive nga Zyra e Cilësisë për stafin akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore tregon se 42% e tyre kanë arritur një nivel maksimal të vlerësimit, ndërsa mesatarja e përgjithshme është 49%. Në anën tjetër, vetëm 9% e vlerësimeve kanë rezultuar në një nivel të ulët të performancës. Kjo tregon për një nivel të lartë cilësie dhe përkushtimi në përparimin akademik të stafit të fakultetit

Figura 9. Analiza e vlerësimeve negative sipas kriterëve nga ZC për stafin akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore



Sipas analizës së vlerësimeve negative nga Zyra e Cilësisë për stafin akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, 73% e tyre janë vlerësuar si të rregullt, ndërsa 14% kanë marrë vërejtje për përmirësime të mundshme. Megjithatë, 13% e vlerësimeve kanë rezultuar në një vlerësim negativ. Kjo sugjeron një nevojë të vazhdueshme për përmirësim dhe përkushtim nga ana e të gjithë stafit akademik për të arritur standardet e kërkuara të cilësisë.

Figura 10. Analiza e komenteve pozitive dhe negative nga ZC për stafin akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore



Nga analizimi i komenteve pozitive dhe negative nga Zyra e Cilësisë për stafin akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore tregon se 73% e tyre janë komente pozitive, duke treguar një përshtatje të mirë të stafit me kriteret dhe pritshmërinë e institucionit. Një pjesë prej 21% janë rekomandime për përmirësime të mundshme, që shfaqin vullnetin për të avancuar dhe për të përmirësuar performancën. Ndërsa vetëm 6% janë komente të cilat rekomandojnë të lexohen për të adresuar çështje specifike. Kjo analizë tregon për një perceptim pozitiv të përgjithshëm ndaj stafit akademik, ndërsa gjithashtu identifikon disa fusha potenciale për rritje dhe përmirësim të mëtejshëm.

REKOMANDIMET NGA ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Zyra për Sigurimin e Cilësisë ka analizuar raportin e vlerësimit të stafit akademik nga studentët. Raporti është ndarë në dy pjesë: pjesa e parë paraqet gjendjen e përgjithshme të fakultetit, ndërsa pjesa e dytë, e cila është hartuar në Excel, paraqet gjendjen individuale të profesorëve dhe analizën e vlerësimeve individuale për secilin prej tyre, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë.

Rezultatet e paraqitura në raportin në fjalë tregojnë se, në pjesën më të madhe të rasteve, studentët kanë dhënë vlerësime pozitive për stafin akademik, dhe një pjesë e konsiderueshme prej tyre ka shprehur komente pozitive. Sidoqoftë, një numër i vogël i stafit akademik ka marrë vlerësime dhe komente negative. Bazuar në këto gjetje, Zyra për Sigurimin e Cilësisë rekomandon:

- Të shqyrtohen të gjitha vlerësimet dhe komentet negative për çdo profesor.
- Të ftohen në takime individuale profesorët me vlerësime dhe komente negative për të identifikuar mangësitë në bashkëbisedim me profesorin.
- Rekomandohen trajnime për profesorët me vlerësime dhe komente negative në fushat e mëposhtme:
 - Metodologjia e mësimdhënies me fokus tek studenti;
 - Metodatat e vlerësimit dhe politikat akademike;
 - Integrimi i hulumtimeve në procesin mësimdhënës;
 - Trajnime pedagogjike për të theksuar rolin e profesorit në procesin mësimor.

Shtojca/Aneksi

A1. Kriteret për vlerësimet pozitive

Informacione- Vlerësim pozitiv	
Vlerësim maksimal	85% e më shumë vlerësim pozitiv me Pajtohem Plotësisht dhe Pajtohem
Vlerësim mesatar	71% deri 84% vlerësim pozitiv me Pajtohem Plotësisht dhe Pajtohem
Vlerësim i ulët	50% deri 70% vlerësim pozitiv me Pajtohem Plotësisht edhe Pajtohem
Vërejtje	50% e më pak vlerësim me Pajtohem Plotësisht
Komente pozitive	Komentet në përgjithësi janë pozitive dhe domethënëse

A2. Kriteret për vlerësimet negative

Informacione - Vlerësim negativ	
Vërejtje	Më shumë se 8% vlerësim negativ me Nuk Pajtohem Aspak dhe Nuk Pajtohem
Negativë	Më shumë se 5% vlerësim negativ me Nuk Pajtohem Aspak dhe Nuk Pajtohem
Në rregull	Më pak se 5% vlerësim negativ me Nuk Pajtohem Aspak dhe Nuk Pajtohem
Lexo Komentet	Disa komente negative, ose ka Ankesa domethënëse të studenteve